



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prilato Received / Delivery	29.07.2022	viti god year	
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Sësia Koliciteti Quantity
	4429/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.543/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.543/2022 të datës 17.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.543/2022 të datës 17.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 17.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3571/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me mos përzgjedhjen për pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga Instituti Diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bullgarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 23.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit më datë 24.06.2022 ka përcjell në Këshill provat lidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3571/2022 të datës 17.06.2022, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-malin e datës 13.06.2022 nga*



Akademia Diplomatike; E-malin e datës 14.06.2022 nga për ankuesin; E-malin e datës 13.06.2022 nga ankuesi për E E-malin e datës 14.06.2022 nga ankuesi për Akademia Diplomatike; E-malin e datës 16.06.2022 nga Akademia Diplomatike për ankuesin; Komunikim telefonik 11.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 24.06.2022; E-malin e datës 17.06.2022 nga Akademia Diplomatike për ankuesin; E-malin e datës 17.06.2022 nga ankuesi për Notë Verbale Ref.Nr.107/2016 prot:1865 e datës 22.08.2016; E-malin e datës 17.06.2022 nga Akademia Diplomatike; E-malin e datës 05.10.2016 dhe 24.08.2016 nga për ankuesin; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 28.02.2014 për ankuesin; AE.Nr.12/2022 i datës 13.06.2022 për ankuesin; Emailin e datës 01.07.2022 nga Akademia Diplomatike për Shkresë nga Instituti Diplomatik i Republikës së Bullgarisë me numër Ref.Nt-OD-2465 e datës 25.05.2022; E-malin e datës 16.06.2022 nga ankuesi për Akademinë Diplomatike; Notë Verbale nga Ambasada e Republikës së Bullgarisë No.KL-12-102 e datës 30.06.2016; Shkresë nga Instituti Diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Bullgarisë e datës 27.06.2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është bërë i pamundur, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi në bazë të Akt Emërimit AE.Nr.12/2022 të datës 13.06.2022, është i punësuar në pozitën *Zyrtar i Lartë për Emergjencë* në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji gjen se Akademi Diplomatike brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka shpallur ftesë për pjesëmarrje në seminarin e organizuar nga Instituti Bullgar për Diplomaci me titull "*Annual Seminar on Energy and Climate Diplomacy*" nga data 20 qershor deri me 25 qershor 2022. Ankuesi më datë 14.06.2022 ka aplikuar në këtë trajnim, mirëpo Akademia Diplomatike më datë 16.06.2022 ka njoftuar ankuesin se nuk është përzgjedhur për pjesëmarrje në këtë trajnim, me arsyetimin se ankuesi ka qenë pjesëmarrës në këtë seminar në vitin 2016.

Ankuesi i pakënaqur me mos përzgjedhjen, brenda aftit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin se nuk qëndron arsyetimi për refuzimin e kërkesës së ankuesit për pjesëmarrje në Seminarin e organizuar nga Instituti Bullgar për Diplomaci me titull "*Annual Seminar on Energy and Climate Diplomacy*" nga data 26 qershor deri me 25 qershor 2022, sepse i njëjti është ftuar nga asistentja që të marr pjesë në trajnimin në Daka/Bagladesh.

Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se objekt kontesti sipas ankesës është kundërshtimimi i mos përzgjedhjes së ankuesit për pjesëmarrje në seminarin e organizuar nga Instituti Diplomatik Bullgar me temën "*Annual Seminar on Energy and Climate Diplomacy*" dhe si rrjedhojë duke marrë parasysh faktin se seminari në fjalë ka qenë i planifikuar të mbahet nga data 20.06.2022 deri më datë 25.06.2022, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur me rastin e vendosjes lidhur me ankesën, andaj mbi këto arsye e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*", Kolegji konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative të filluar me ankesën me numër A.nr.543/2022 të datës 17.06.2022.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.543/2022

**Avdyll BEKTESHI**

*Avdyll Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe;
- Arkivoit të KPMSHCK-së

